

## Të drejtat e Prindit/Kujdestarit të nxënësit me Edukim Special

Njoftimi për Masat Mbrojtëse Proçeduriale, përshkruan të drejtat e prindit/kujdestarit të një fëmije me paaftësi dhe proçedurat, që garantojnë këto të drejta, në përshtatje me ligjin e edukimit të shtetit dhe federalit. Disa prej të drejtave më kryesore për prindin/kujdestarin janë theksuar më poshtë, bashkë me udhëzimet për prindërit/kujdestarët, gjuha amtare e të cilëve nuk është Anglishtja, të cilët mund të duanë ndihmë për përkthim/interpretim nga Drejtoria Arsimore.

- E drejta për privatësi, inspektim dhe rishikim të rekordeve mësimore të fëmijës tuaj.
- E drejta për dhënien e pëlqimit, ose tërheqjen e tij, përpara një vlerësimi, rivlerësimi dhe vendosjen fillestare në një plan të edukimit special.
- E drejta e pjesëmarrjes në takimet për identifikimin, vlerësimin, ose vendosjen e fëmijës tuaj dhe sigurimin e FAPE (edukimin e duhur publik falas) për të.
- E drejta e marrjes paraprakisht të njoftimit për çdo ndryshim në programin e edukimit të fëmijës, ose të Planit të Edukimit të Individualizuar (IEP).
- E drejta për Edukimin e Duhur Publik Falas (FAPE) për fëmijën, pa kosto për ju.
- E drejta që fëmija juaj të ndjekë klasa, të marrë pjesë në aktivitetet jo mësimore dhe jashtë kurrikulës për të marrë shërbime me fëmijët, të cilët nuk kanë paaftësi, në maksimumin e mundshëm të tyre.
- E drejta për të kërkuar një proçes dëgjimi të paanshëm, nëse ju nuk dakortësoheni me identifikimin e ekipit të IEP, vlerësimin, vendosjen, ose sigurimin e FAPE për fëmijën tuaj.
- E drejta për tërheqjen e pëlqimit për vazhdimin e edukimit special dhe shërbimeve përkatëse.
- E drejta për pjesëmarrje kuptimplotë në proçesin IEP.
- E drejta për marrjen e shërbimeve të interpretimit dhe/ose përkthimit nga Drejtoria Arsimore. Ju jeni të inkurajuar të merrni në çdo kohë shërbimet e përkthimeve dhe interpretimeve nga Drejtoria Arsimore. Për shëmbull, Asistentët Dytëgjesh të Këshilltarit (BCA\_të) do të jenë të gatshëm, që sipas nevojave të kryejnë rolin e interpretuesit në gjuhën tuaj. Në vazhdim, ju jeni të inkurajuar të kërkonit interpretim/përkthim të mëtejshëm, nëse shërbimet e interpretimit nuk ju lejojnë pjesëmarrje të plotë në proçesin e IEP. Ju mund t'a realizoni këtë duke kontaktuar Koordinatorin për Edukimin Special (SEL) të caktuar në shkollën e fëmijës tuaj

Për një përshkrim më të plotë të të drejtave të prindit/kujdestarit, ju lutemi referohuni në Njoftimin për Masat Mbrojtëse Proçeduriale. Manuali i plotë i Masave Mbrojtëse mund të gjendet në uebsajtin e mëposhtëm: